



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA E KURRIKULËS DHE KUALIFIKIMIT

Nr. ____ prot.

Tiranë ____ .01. 2025

Njoftim për “Bashkëpunëtorë të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit
Parauniversitar”

Në mbështetje të nenit 58, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr.98, datë 27.02.2019, të Kryeministrit, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar” (ASCAP), nenit 7 dhe nenet 10-12 të Urdhrit të Ministrit nr.32, datë 28.01.2020, “Për përcaktimin e metodave të brendshme të punës dhe sjelljes së personelit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar”, në zbatim të planit të veprimtarive të ASCAP, shpall kërkesën për bashkëpunëtorë të jashtëm që mund të angazhohen në realizimin e veprimtarive të planifikuara dhe miratuara në planin e punës së institucionit.

Bashkëpunëtorët është e nevojshme të plotësojnë këto kërkesa:

1. Të kenë mbaruar arsimin e lartë me kohë të plotë në një nga degët e mësuesisë.
2. Të kenë të paktën 3 vjet eksperiencë pune në arsim.
3. Të kenë përvojë paraprake në një ose disa nga veprimtaritë e mëposhtme:
 - Zhvillimin dhe zbatimin e kurrikulës në profile dhe cikle të ndryshme;
 - Zhvillimin profesional të mësuesve (përgatitje e materialeve për trajnimin e mësuesve, zhvillim i trajnimeve etj.);
 - Menaxhimin e veprimtarive apo projekteve në institucionin arsimor ku punon;
 - Drejtimin dhe menaxhimin e institucionit arsimor;
 - Mbështetjen e shërbimit psiko-social në institucionin arsimor;
 - Mbështetje të sigurisë së nxënësve në mjedisin arsimor;
 - Sigurimin e gjithpërfshirjes në institucionet arsimore;
 - Bashkëpunime me ASCAP dhe institucione të tjera të varësisë së MAS për realizimin e veprimtarive të tyre mbështetje të edukimit në arsimin parauniversitar;
 - Etj.
4. Të kenë aftësi bashkëpunuese dhe aftësi të punës në grup.
5. Preferohen përfshirjet afatgjata në fushat e mësipërme të veprimtarive.
6. Preferohet zotërimi i gjuhës angleze.
7. Preferohen me aftësi të mira digjitale.

Kandidatët duhet të dorëzojnë CV-në, fotokopje të diplomës dhe fotokopje të dokumentit të identitetit pranë sekretarisë së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP), në adresën: Rruga "Naim Frashëri", Nr.37, Tiranë ose emailin sekretaria@ascap.edu.al brenda datës 20.01.2025, ora 16.30.

Faleminderit!